



AIDA

Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

SEKTORI I FRUTA - PERIMEVE



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001



AIDA

Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Historiku i sektorit dhe karakteristikat e tij

Statistika të viteve të fundit

Kontributi në punësim

Pesha në eksport

Rritja dhe qëndrueshmëria e sektorit

Proceset e punës, produktet, shërbimet

Standardet dhe certifikimi

Avantazhet e sektorit

Histori suksesi

Mbështetja e sektorit nga shteti dhe AIDA

HISTORIKU I SEKTORIT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

Sektori i përpunimit të frutave dhe perimeve në Shqipëri është një nënndarje e rëndësishme e bujqësisë. Bujqësia ka qenë dega më e rëndësishme ekonomike në prodhimin kombëtar (së bashku me industrinë ushqimore) ka zënë më shumë se 20% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP). Sektori i fruta perimeve deri para viteve '90 është konsideruar në nivel të mirë dhe përqendrohej në kultivimin e lëndëve të para. Sektori ishte në gjëndje të mbulonte nevojat e brendshme si dhe të eksportonte fruta dhe perime të konservuara mesdhetare, salcat dhe fruta të thata. Përpunimi i fruta perimeve deri para viteve '90 organizohej në ato që quheshin "Ushqimore", ndërsa këto fruta kultivoheshin në sera dhe fusha të organizuara në kooperativa sipas organizimit politik të para viteve '90.

Pas privatizimit të sektorit të frutave dhe perimeve, ka pasur përpjekje për të nisur biznesin e përpunimit. Në fillim të vitit 2000, industria e restauruar shënoi një progres të lehtë pozitiv në nivelin e prodhimit. Megjithatë, në kohën e këtij vlerësimi, performanca e industrisë nuk ishte në nivelin e saj më të lartë, pasi u ndikua nga kriza financiare e vitit 2008. Qarkullimi vjetor i llogaritur prej mesatarisht 10 milionë Euro vjen nga një duzinë kompanish, me prodhim të përgjithshëm të përpunuar prej 15,000 ton, nga një ndarje e përafërt prej 70% perime dhe 30% fruta. Produktet kryesore të përpunuara janë salcat, kompostot, fruta të konservuara, reçeli, marmalada, sallatra të përziera, salcë, sallatë dhe perime të marinuara. Perimet dhe frutat sigurohen kryesisht (rreth 80% e tyre) nga furnitorët lokalë. Rreth 90% e produkteve të përpunuara shërbejnë për të furnizuar tregun lokal me eksporte të vogla por të vazhdueshme në vendet fqinje, kryesisht në Greqi dhe Kosovë.



STATISTIKA TË VITEVE TË FUNDIT

Të dhënat statistikore nga INSTAT, dëshmojnë për një rritje progresive të sektorit të fruta perimeve gjatë 5 viteve të fundit. Konkretisht, për sasinë totale të prodhimit dhe sipërfaqen totale të kultivuar, të dhënat ndër vite vijojnë si më poshtë:

| Viti | 2016 | 2020 |
|---|-----------|-----------|
| Sasia totale e perimeve të prodhuara (në ton) | 1,219,101 | 1,295,726 |
| Sasia totale e frutave të prodhuara (në ton) | 205,900 | 199,100 |
| Sipërfaqja totale e kultivuar (në ha) | 38,803 | 42,673 |



KONTRIBUTI NË PUNËSIM

Industria e fruta perimeve perbën një nën-degë kryesore të sektorit të bujqësisë. Si rrjedhojë, edhe numri i të punësuarve në këtë industri zë një pjesë të konsiderueshme të totalit të punësimit.

Në vitin 2016, numri total i fermerëve ishte **31,372** nga të cilët 2, 695 ishin gra (8.6%).

Ndërsa në vitin 2020, numri total i fermerëve ishte **46,743** dhe gratë përbënin 9,1% të totalit. Pjesa më e madhe e të punësuarve në këtë sektor përbëhet nga meshkujt, rreth 64%, ndërsa grupmosha e të punësuarve është relativisht e gjërë, varion nga 24-62 vjeç.

Në fund të vitit 2020, paga mesatare mujore bruto në bujqësi ishte rreth **33,000** lekë.

PESHA NË EKSPORT

Eksportet e frutave, perimeve dhe zarzavateve shënuan rritje vitin e kaluar, me mbi 10%. Sipas të dhënave të INSTAT mbi tregtinë e jashtme mësohet se frutat dhe perimet e prodhuara në vend realizuan rreth 10,4 miliardë lekë ose 84 milionë euro vlerë shitjesh në tregjet jashtë vendit.

Të dhënat nga tregu bëjnë me dije se rritja e shitjeve erdhi si pasojë e një sezoni më të mbarë prodhimi sidomos nga kushtet me të favorshme të motit.

Vlerën më të madhe të eksportit e shënuan zarzavatet me rreth 7.8 miliardë lekë të përfaqësuar nga rritja e kontratave me jashtë për shitjen e domates. Eksporti i zarzavateve në veçanti shënoi 7.8 miliardë lekë ose 63 milionë euro me një rritje 5,3% në raport me një vit më parë.

Ndërsa eksporti i frutave në vlerë është më i vogël me vetëm 2,6 miliardë lekë, por rritja në raport me vitin 2018 ishte me lartë, me rreth 25%.

Baza e eksporteve të frutave dhe perimeve është zgjeruar dukshëm gjatë pesëvjeçarit të fundit. Vlera e tyre është katërfishuar nga viti 2016, nga



2,8 miliardë lekë në vlerën e 10,4 miliardë lekë për vitin 2020.


Shkak për këtë rritje më së shumti janë faktorët gjeografikë, të cilët mundësojnë prodhimin më të hershëm të frutave dhe perimeve nga vendi ynë.

Të dhënat tregojnë se vitin e kaluar janë importuar 9.4 miliardë lekë ose rreth 77 milionë euro fruta dhe zarzavate nga jashtë vendit.


Vlerën më të lartë të importit e shënojnë frutat. Në 2019 u importuan gjithsej 6,8 miliardë lekë. Në tregtinë e frutave me jashtë Shqipëria është deficitare, pasi importon 6,8 miliardë lekë ose gati tre herë më shumë se eksporton.

Nga ana tjetër, Shqipëria është suficitare në tregtinë e perimeve dhe zarzavateve pasi eksporton 7,8 miliardë lekë dhe importon 2,5 miliardë lekë në vitin 2019.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mbi ecurinë e importit për fruta dhe perime në Shqipëri, për periudhën 2013-2019.



Ecuria e eksportit dhe importit të frutave dhe zarzavateve 2013-2019



RRITJA DHE QËNDRUESHMËRIA E SEKTORIT



Sektori i fruta perimeve konsiderohet si një industri me kërkesa konsumatore të qëndrueshme, e cila siguron të ardhura ekonomike të vazhdueshme dhe që në raport me industritë e tjera është më rezistente ndaj periudhave të reçensionit.

Prodhimi i fruta perimeve është i lidhur ngushtë me bujqësinë, duke vepruar si furnizues i lëndës së parë për një pjesë kryesore të kësaj industrie.

Objektivat kryesore të kësaj industrie në vendin tonë janë:

- **Rritja** e prodhimit;
- **Modernizimi** i prodhimit dhe zgjerimi i kapacitetit prodhues;
- **Zhvillimi** i logjistikës dhe infrastrukturës së tregut të ushqimit;
- **Përmirësimi** i konkurrueshmërisë së produkteve me qëllim zëvendësimin e importit dhe rritjen e eksporteve.



Disa tregues bazik që dëshmojnë për rritjen dhe qëndrueshmërinë e sektorit të fruta perimeve në vendin tonë janë:

Numri gjithnjë e në rritje i subjekteve që ushtrojnë aktivitetin në sektorin e fruta perimeve;

Zgjerimi i hartës së eksporteve (referuar të dhënave nga doganat, fruta perimet shqiptare eksportohen në mbi 30 vende të ndryshme të botës);

Rritja e volumeve në vlerë dhe sasi.



PROCESET E PUNËS, PRODUKTET, SHËRBIMET

Sektori i fruta perimeve, është një degë shumë e rëndësishme e bujqësisë, dhe si e tillë produktet e këtij sektori kalojnë të gjitha proceset dhe shërbimet që dikton kjo industri.



Një listë me praktikat kryesore dhe hapat e proceseve që kalojnë produktet e fruta perimeve renditet si më poshtë:

- Përgatitja e tokës
- Mbjellja
- Plehërimi
- Ujitja
- Shkulja e barërave
- Menaxhimi i integruar i dëmtuesve
- Integrimi i të korrave
- Vjelja
- Ruajtja e të korrave
- Grumbullimi
- Paketimi sipas volumeve
- Transporti

Prodhimi dhe grumbullimi i fruta perimeve kryesisht i përmbahet proceseve klasike të bujqësisë dhe është i bazuar në metodat mekanike dhe tradicionale të prodhimit dhe grumbullimit. Inovacioni dhe zhvillimi teknologjik në subjektet e këtij sektori përbëhet kryesisht nga investimet bashkëkohore të magazinave për ruajtjen e produkteve sipas standarteve të sigurisë ushqimore të rekomanduara dhe të mjeteve frigoriferike të transportit, të cilat duhen të jenë gjithashtu, në përputhje të plotë me rregullat dhe standardet e sigurisë ushqimore.

STANDARDET DHE CERTIFIKIMI

Megjithëse certifikimi i sigurisë ushqimore nuk është i detyrueshëm sipas legjislacionit europian, ai është bërë një domosdoshmëri për pothuajse të gjithë importuesit europianë të ushqimit. Certifikimi i sigurisë ushqimore është shumë i rëndësishëm në eksportin e produkteve në vendet anëtare të BE. Kërkesat shtesë të blerësve për standarde të caktuara janë të ndryshme. Për eksportin e frutave dhe perimeve të freskëta blerësit kryesisht kërkojnë standardin Global G.A.P.

Standardi Global G.A.P është standard i njohur ndërkombëtarisht për prodhime bujqësore të fermës. Certifikimi GLOBAL G.A.P. mbulon fushat:

- Siguria dhe gjurmimi i ushqimit
- Mjedisi (përfshirë biodiversitetin)
- Shëndeti, siguria dhe mirëqenia e punëtorëve
- Mirëqenia e kafshëve

- Menaxhimi i Integruar i Prodhimeve (ICM), Kontrolli i Integruar i Dëmtuesve (pesticideve) (IPC)
- Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (QMS) dhe Analiza e Rrezikut dhe Pikat e Kontrollit Kritik (HACCP).

Certifikimi i produkteve shqiptare sipas standardit Global G.A.P u mundëson kompanive të nënshkruajnë kontrata me vlera më të larta me tregjet e Europës Perëndimore, të sigurojnë rritje graduale dhe të qëndrueshme të këtij sektori në vendin tonë.

Ndër certifikimet e tjera më të kërkuara të sektorit të fruta perimeve mund të përmendim:

1. IFS –“International Featured Standard” ose standardi IFS Food, aplikohet kur produktet janë “procesuar” ose kur ka një rrezik për ndotje gjatë paketimit në ambalazhet primare. IFS Food Standard është i rëndësishëm për të gjithë prodhuesit, në veçanti për prodhuesit nënkontraktorë, të cilët kanë për qëllim të përmbushin kërkesat e blerësve. Theksi i jepet sigurisë ushqimore dhe cilësisë së proceseve dhe produkteve.

2. BRC - Standardi Global për Sigurinë Ushqimore i Konsorciumit Britanik të Shitjes me Pakicë. Në tregtinë botërore të ushqimit, Standardi ushqimor BRC është një mjet i besueshëm për prodhuesit për t'u provuar klientëve të tyre se ata lehtë mund të marrin pjesë në programet e tyre të sigurisë ushqimore dhe zinxhirin e furnizimit. Standardi ushqimor BRC është zhvilluar nga shitësit me pakicë, ekspertët e industrisë ushqimore dhe organizatat e lidhura me to, fillimisht vetëm në Angli, e tashmë është një standard internacional i përdorur nga shumica e vendeve të zhvilluara perëndimore.

3. ISO 22000:2005 (Sistemi i Manaxhimit të Sigurisë Ushqimore) është menduar për të gjitha kompanitë e përfshira në zinxhirin ushqimor (nga prodhuesit e ushqimit, prodhuesit e lëndës së parë deri te konsumatorët e fundit, si dhe prodhuesit e materialeve që janë në kontakt me ushqimin), të cilat potencialisht mund të shkaktojnë ndotjen e ushqimit, pavarësisht nga madhësia dhe organizimi i tyre.

Certifikimi në grup Global G.A.P është një tjetër alternativë e qëndrueshme për të nxitur bashkëpunimin dhe promovuar eksportet në tregje të zhvilluara perëndimore.

Certifikimi me standardin Global G.A.P në grup i mundëson eksportuesit dhe grupit të prodhuesve të ruajnë standardin, të ulin kostot dhe së bashku të fillojnë të furnizojnë furnitorët e rrjeteve të supermarketeve në Evropë, të cilët kanë kriter të parë certifikimin Global G.A.P. Këto tregje të mëdha ofrojnë marzhe me të larta fitimi me shumë qëndrueshmëri, diversifikim të riskut dhe mundësi për tu rritur eksportet pasi janë tregje të mëdha.

Me certifikimin në grup fermerët nuk reduktojnë vetëm kostot e certifikimit por:

Rrisin ndjeshëm cilësinë e produkteve;

Lidhin kontrata afatgjata në tregje të reja duke garantuar cilësi dhe sasi;

Shesin me çmime më të larta në vende të zhvilluara Europiane;


Rrisin sigurinë dhe besueshmërinë ndaj klientëve duke përmirësuar imazhin e tyre.

AVANTAZHET E SEKTORIT

Rritja e prodhimit bujqësor, jo vetëm që zhvillon ekonominë dhe ul papunësinë, por mundëson uljen e çmimeve të produkteve kryesore jetike që konsumohen nga popullata, si dhe ul varësinë e vendit nga importet.

Ndër avantazhet që favorizojnë zhvillimin e këtij sektori në Shqipëri janë:

- Klimë e përshtatshme për kultivimin e produkteve të ndryshme, tokë pjellore dhe burime ujore.
- Një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore në legjislacionin thelbësor të zbatueshëm që rregullon sektorin e bujqësisë në Shqipëri, si: (i) sektorin dhe operatorët përkatës; (ii) regjimin ligjor të tokës bujqësore; (iii) financimin dhe ndihmën shtetërore; dhe (iv) stimujt përkatës, duke përfshirë edhe stimujt fiskalë.
- Legjislacioni përkatës bazë i miratuar nga Republika e Shqipërisë përbëhet nga: - Vendimi i Këshillit nr.709, datë 29.10.2014 "Për Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor"; - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.700, datë 12.10.2016 "Strategjia Kombëtare Shqiptare e Konsolidimit të Tokës"; dhe Strategjia për Ujitjen dhe Kullimin 2018-2030 (në proces hartimi). Vlen të përmendet se në kuadrin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, Shqipëria ka vazhduar të zbatojë dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA).



- Reduktimi i tatimit në 5% për shoqëritë e bashkuara bujqësore apo heqja e taksave për naftën për fermerët.
- Skema e naftës falas 9.5 miliardë lekë ku përfitues janë të gjithë fermerët me një NIPT aktiv dhe që punojnë jo më pak se 0.4 ha tokë.
- Marrëveshje tregtare preferenciale me BE për rritjen e eksporteve dhe marrëveshje tregtare preferenciale me vendet e Ballkanit (CEFTA).
- Kosto konkurruese e faktorit punë.
- Rritje e qendrueshme dhe e vazhdueshme e sektorit në vitet e fundit.
- Më shumë se 40% të të punësuarve i përkasin sektorit të bujqësisë.
- 42 % tokë e papërdorur.

KOMPANI TË RËNDËSISHME TË SEKTORIT

Bazuar mbi shtrirjen gjeografike, volumin e produkteve dhe numrin e punonjësve më poshtë përmenden disa kompani të rëndësishme të sektorit të industrisë së sektorit fruta – perime:

- | | | |
|------------------------|--------------------------|------------------------------|
| 1. Doni Frut sh.p.k | 4. Lea 2012 sh.p.k | 7. Kujtim Lika imp-ex sh.p.k |
| 2. Gorea 07 sh.p.k | 5. Agro Divjaka sh.p.k | 8. Tomato.al sh.p.k |
| 3. Kamila Fruit sh.p.k | 6. Gjergji imp-ex sh.p.k | 9. Frigo Vasport sh.p.k |

HISTORI SUKSESI

Tomato.al është një kompani që operon prej vitit 1998 dhe eksporton fruta-perime shqiptare në rajon dhe në shumë vende europiane. Kompania ka një staf shumë të organizuar me rreth 60 punonjës. Gjithashtu, kompania bashkëpunon me shumë fermerë të vegjel të zonës së Beratit, duke krijuar kështu mundësi indirekte punësimi dhe një burim të ardhurash për të gjithë zonën. Ambientet e kompanisë janë shumë bashkëkohore dhe të përshtatura sipas rekomandimeve dhe standardeve europiane, si për kushtet e punës së punonjësve ashtu dhe për kushtet e grumbullimit, ambalazhimit dhe ruajtjes së produkteve. Aktualisht, kompania punon me kapacitet të plotë, duke përpunuar rreth 200 ton fruta perime në ditë, të cilat eksportohen në 22 shtete të ndryshme.

MBËSHTETJA E SEKTORIT NGA SHTETI DHE AIDA

Kompanitë që ushtrojnë aktivitetin në industrinë e fruta perimeve, si një pjesë shumë e rëndësishme e sektorit të bujqësisë, kanë qënë vazhdimisht në fokus të qeverisë, për t'u mbështetur dhe për t'u krijuar lehtësira, në mënyrë që të nxitët zgjerimi i aktivitetit të tyre dhe rritja e eksporteve.

Disa nga programet mbështetëse kryesore që qeveria ka vënë në dispozicion për këtë sektor, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe AZHBR janë si më poshtë:

- Programi IPARD: është mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga fondet e BE-së (75%) dhe qeverisë shqiptare (25%).
- Skema Kombëtare: është mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga buxheti i qeverisë shqiptare. Përfitues të masave mbështetëse, nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët, personat fizikë, juridikë, SHBB-të dhe UBT-ja.
- Shërbimet Mjedimore: janë mbështetje financiare për zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve nga Banka Botërore dhe Qeveria Suedeze.
- Fondi i Garancisë: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Qeveria Shqiptare nisën në vitin 2016, Programin për Mbështetjen e Agrobiznesit Shqiptar (AASF). Qëllimi i këtij programi është të motivojë institucionet financiare shqiptare për të mbështetur një sektor vital të ekonomisë shqiptare me potenciale gjerësisht të pashfrytëzuara si: bujqësia dhe agrobizneset.

Gjithashtu, subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e fruta-perimeve, mund të përfitojnë nga shërbimet që AIDA ka ofruar dhe ofron në mbështetje të biznesit vendas. Disa nga shërbimet kryesore janë janë:

- Analiza sektoriale të tregut dhe sektorët e mundshëm për investime.
- Këshilla për gjetjen e pronave dhe vendndodhjeve të përshtatshme (në rastet kur kompanitë synojnë të zgjerohen ose të nisin një investim nga e para).
- Ndihma në identifikimin e projekteve të ardhshme dhe ekzistuese të investimeve në Shqipëri.
- Identifikimi i eksportuesve vendorë, partnerëve të biznesit ose kontakteve institucionale.
- Organizimi i aktiviteteve ndërmjetësuse dhe panai-reve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Grantet financiare dhe mundësitë e financimit nga projekte të ndryshme të BE-së, që kanë në fokus nxitjen dhe mbështetjen e prodhuesve shqiptarë për aksesin në tregje të reja.
- Portali B2B për gjetjen e partneriteteve potenciale.



Enterprise Europe Network



AIDA, nëpërmjet zbatimit të Rrjetit European të Ndërmarrjeve në Shqipëri (EEN-Albania), mundëson për biznesin shqiptar mbështetje, si:

- Marrëveshje ndërkombëtare (ekspertizë, kontakte, aktivitete për të lidhur kompanitë shqiptare me partnerë potencialë të huaj, për të rritur biznesin e tyre).
- Këshillim për rritje ndërkombëtare (këshillim nga ekspertët për rritje dhe zgjerim në tregjet ndërkombëtare).
- Inovacioni në biznes (shërbime të orientuara nga zgjidhja për të ndihmuar kompanitë të kthejnë idetë e tyre inovative në suksese tregtare ndërkombëtare).



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001

